

VENDIM
Nr.355, datë 13.5.1996

PËR KRYERJEN E REGJISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË NJËSIVE EKONOMIKE
BUJQËSORE

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.7687, datë 16.3.1993 "Për statistikën", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe Institutit të Statistikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Regjistrimi i përgjithshëm i njësive ekonomike bujqësore shqiptare do të bëhet 1 herë në 10 vjet. Regjistrimi i parë do të fillojë në shtator të vitit 1996.

2. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Financave, me propozimin e Institutit të Statistikës, miratojnë treguesit e nevojshëm.

3. Për organizimin dhe kryerjen e regjistrimit krijohet Komisioni Qendror i Regjistrimit. Ky komision cakton përbërjen e komisioneve lokale, si dhe të zyrave të regjistrimit në komuna e bashki.

Përbërja e Komisionit Qendror të Regjistrimit është sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

4. Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore do të angazhohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Instituti i Statistikës dhe Sekretariati i Shtetit për Pushtetin Lokal.

5. Instituti i Statistikës bën udhëheqjen metodologjike, përpunimin e të dhënave dhe botimin e rezultateve të regjistrimit.

6. Shpenzimet e nevojshme për mbulimin e kësaj veprimtarie të përballohen nga Instituti i Statistikës dhe nga ndihma e Qeverisë italiane.

7. Fusha e vrojtimit të regjistrimit të përgjithshëm të përfshijë të gjitha njësitë ekonomike bujqësore, blegtorale e pyjore (private ose shtetërore).

8. Subjektet private ose shtetërore, që janë objekt i regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore, janë të detyruara të japin informacion korrekt e të vërtetë sipas pyetësorëve të hartuar nga Instituti i Statistikës.

Për kundërvajtësit zbatohen sanksione të parashikuara në ligjin nr.7687, datë 16.3.1993 "Për statistikën".

9. Të dhënat e grumbulluara nga regjistrimi i përgjithshëm i njësive ekonomike bujqësore përbëjnë sekret statistikor. Shpërndarja dhe publikimi i tyre bëhet vetëm në formë të grupuar.

10. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Instituti i Statistikës të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

PËRBËRJA E KOMISIONIT QENDROR TË REGJISTRIMIT

1. Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit	Kryetar
2. Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it	Sekretar
3. Sekretari i Shtetit për Pushtetin Lokal	Anëtar
4. Kryeregjistratori i pasurive të paluajtshme	"
5. Drejtori i Drejtorisë së Kadastrës në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit	"
6. Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit	"
7. Drejtori i Drejtorisë së Statistikave në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit	"

8. Shefi i Departamentit të Bujqësisë në INSTAT

“